



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 3031/1 Prot.

Tiranë, më 27.05.2022

Lënda: Monitorimi i 4-mujorit të parë të buxhetit për vitin 2022.

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, bazuar në udhëzimin nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetin të vitit 2022”, si dhe shkresës Tuaj nr. 2854 prot., datë 20.5.2022, “Monitorimi i 4-mujorit të parë të buxhetit për vitin 2022”, po ju dërgojmë të dhënat mbi:

- Shpenzimet e realizuara për 4-mujorin e parë të buxhetit për vitin 2022 për të gjitha zërat buxhetor, duke përfshirë dhe institucionet e varësisë, rakorduar dhe me thesarin;
- Numrin e analizave/inspektimeve etj., të realizuara për periudhën janar- prill 2022;
- Realizimi i zërave buxhetor për 4-mujorin e parë përshkruar me shifra dhe në mënyrë narrative.

a) REALIZIMI I BUXHETIT 4- MUJORI I PARË 2022

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nga ana buxhetore është i organizuar në 13 njësi shpenzuese, Drejtoria e Përgjithshme dhe 12 Drejtori Rajonale të cilat administrojnë buxhet më vete për shpenzimet korente (*paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative*), dhe një njësi shpenzuese për sa i përket shpenzimeve kapitale (*investimet*) të cilat janë të përqendruara në organin qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit .

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kuadrin normativ si edhe nevojat e institucionit, janë menaxhuar me efikasitet fondet buxhetore të akorduara për AKU.

Fondet e Akorduara dhe të Realizuara 4/mujorin e parë 2022:

Llogaria Ekonomike	Buxheti Fillestar viti 2022	Ndryshimet gjate vitit		Buxheti total plan viti 2022	Realizimi i Buxhetit 4/mujor (2022)	Realizimi (%)
		Shtesa	Paksime			
600	349,500,000		18,566,000	330,934,000	107,893,048	33
601	59,500,000		4,168,000	55,332,000	18,023,599	33
602	117,752,000		11,780,000	105,972,000	20,788,527	20
606	1,448,000			1,448,000	180,000	12
231	104,755,000			104,755,000		0
Totali	632,955,000	0	34,514,000	598,441,000	146,885,174	25

Realizimi i zërave të buxhetit në 4-mujorin e parë 2022 është 25 %, themi që është një rezultat i kënaqshëm.

Duke monitoruar të 13 njësitë shpenzuese të Autoriteti Kombëtar të Ushqimit, realizimi i buxhetit 4-mujor paraqitet si më poshtë, të dhënat janë të rakorduara dhe me degët e Thesarit:

Realizimi i zerave buxhetor 4/mujori i pare 2022													/000leke	
NR	Kodi Institucionit	Emri institucionit	Investime Llogaria 231		Paga Llogaria. 600		Sig.Shoq Llogaria. 601		Operative Llogaria.		Llogaria. 606		TOTALI I BUXHETIT	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	1005118	AKU Qendrore	104,755		95,000	30,678	15,850	5,104	53,172	5,824	1,268		270,045	41,606
2	1005119	Drejtoria Rajonale Berat			14,690	4,719	2,450	799	2,600	477	0		19,740	5,995
3	1005120	Drejtoria Rajonale Diber			11,750	3,812	1,970	641	2,900	467			16,620	4,921
4	1005121	Drejtoria Rajonale Durres			22,290	7,216	3,730	1,205	7,000	2,030	0		33,020	10,451
5	1005122	Drejtoria Rajonale Elbasan			17,250	5,622	2,880	938	4,500	1,581	0		24,630	8,141
6	1005123	Drejtoria Rajonale Fier			15,890	5,090	2,660	850	4,500	1,189	0		23,050	7,129
7	1005124	Drejtoria Rajonale Gjirokastr			19,000	6,118	3,200	1,032	4,500	1,146	30	30	26,730	8,326
8	1005125	Drejtoria Rajonale Korce			27,230	8,607	4,547	1,437	6,000	1,838	0		37,777	11,882
9	1005126	Drejtoria Rajonale Kukes			14,530	4,553	2,425	760	2,600	433	0		19,555	5,747
10	1005127	Drejtoria Rajonale Lezhe			12,044	4,130	2,020	690	2,700	658	30	30	16,794	5,508
11	1005128	Drejtoria Rajonale Shkoder			18,550	5,986	3,100	994	4,500	1,326	120	120	26,270	8,427
12	1005129	Drejtoria Rajonale Tirane			42,990	14,332	7,200	2,398	7,000	2,857	0		57,190	19,587
13	1005130	Drejtoria Rajonale Vlore			19,720	7,029	3,300	1,174	4,000	962	0		27,020	9,165
TOTALI			104,755	0	330,934	107,893	55,332	18,024	105,972	20,789	1,448	180	598,441	146,885

b) REALIZIMI I INSPEKTIMEVE DHE ANALIZAVE 4- MUJORI I PARË 2022

1. Për periudhën e 4-mujorit të parë 2022 janë kryer gjithsej **34.590** inspektime nga sektorët KUUKOBU, MBIB dhe PIK

Janë marrë masa administrative si më poshtë:

- **1846** Paralajmërim
- **89** Gjoha
- **19** Ndërprerje aktiviteti

SEKTORI	Janar – Prill 2022			
	Nr. i inspektimeve	Gjoha (nr)	Paralajmërim (nr)	Ndërprerje e aktiviteti (nr)
I Kontrollit Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OB Ushqimor	8,949	84	1,816	19
Mbrojtje e bimëve dhe imputeve Bujqësore	1,751	5	30	
Pikat e Inspektimit Kufitar	23,890			
Total	34,590	89	1,846	19

Inspektimet e planifikuara dhe realizuara sipas Planit Vjetor për vitin 2022 në 4- mujorin e parë 2022, paraqiten si më poshtë:

QARKU -	Inspektime te planifikuara ne planin vjetor te inspektimeve 2022	Realizimi I inspektimeve Janar - Prill 2022			% Realizimit nga Inspektimet e programuara	% Realizimit te inspektimeve te paprogramuara
		Inspektime te Realizuara gjithsej	Nga keto			
			Inspektime te programuara	Inspektime te pa paprogramuara		
TIRANE	2,141	2,458	1,844	614	86.13%	29%
DURRES	1,062	1,310	1,022	288	96.23%	27%
BERAT	652	700	498	202	76.38%	31%
SHKODER	573	551	486	65	84.82%	11%
VLORE	851	786	682	104	80.14%	12%
FIER	1,020	891	765	126	75.00%	12%
DIBER	362	377	304	73	83.98%	20%
ELBASAN	891	1,036	888	148	99.66%	17%
KORCA	1,237	930	801	129	64.75%	10%
LEZHA	523	630	559	71	106.88%	14%
GJIROKASTER	608	605	537	68	88.32%	11%
KUKES	346	426	331	95	95.66%	27%
TOTALI	10,266	10,700	8,717	1,983	84.91%	18.53%

2. Për periudhën e 4-mujorit të parë 2022 janë kryer **3.849** analiza nga Laboratori Fiziko -Kimik , Laboratori Mikrobiologjik, Laboratori i Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve , Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve. Numri i analizave dhe mostrave i detajuar paraqitet si më poshtë:

Janar- Prill 2022	Shërbimet Laboratorike								Origjina e Mostrave			Total		Jokonformiteti	Problematika
	Fiziko-Kimike		Mikrobiologjike		Shëndeti i Kafsheve		Mbrojtje e Bimëve		Kontroll Zyrtar ne:		Autokontroll				
	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	PIK	Terren		Mostra	Analiza		
Tiranë	280	569	0	0	0	0	0	0	9	271	0	280	569	1	Permbajtja e nitriteve ne prodhim mishi (suxhuk)
Durrës	358	1,056	0	0	0	0	6	6	278	86	0	364	1,062		
Shkodër	157	446	7	7	0	0	0	0	38	126	0	164	453		
Fier	85	192	2	2	0	0	0	0	0	87	0	87	194	1	1 moster qumesht i papërpunuar (NPM)
Vlorë	52	159	0	0	0	0	0	0	10	42	0	52	159		
Gjirokastrë	239	641	0	0	0	0	0	0	110	129	0	239	641		
Korcë	415	751	0	0	17	17	3	3	235	185	15	435	771	16	15 mastite, 1 enterotoksemi
TOTAL	1,586	3,814	9	9	17	17	9	9	680	926	15	1,621	3,849	18	

Të dhënat mbi origjinën e mostrave

- 42% janë nga kontrollet zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar;
- 57% nga kontrollet zyrtare në terren;
- 1% të rasteve për analiza vetëkontrolli.

c) REALIZIMI I BUXHETIT 4-MUJOR TË PARË 2022 SIPAS LLOGARIVE

Realizimi i zërave buxhetor sipas llogarive për 4-mujorin e parë të vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Realizimi i zërave Buxhetor 4-mujori i parë 2022

Llogaria Ekonomike	Buxheti total plan viti 2022	Realizimi i Buxhetit (2022)	Realizimi (%)
600	330,934,000	107,893,048	33
601	55,332,000	18,023,599	33
602	105,972,000	20,788,527	20
606	1,448,000	180,000	12
231	104,755,000	0	0
Totali	598,441,000	146,885,174	25

1. **Realizimi i buxhetit 4-mujor 2022 në llogarinë 600 dhe 601** është në masën 33% , si rezultat i vendeve vakant në stafin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nga 433 punonjës me strukturë numri mesatar i punonjësve ka qënë 423 , si dhe janë paguar dhe 4 punonjës me kontratë në periudhën Mars, Prill 2022.
2. **Realizimi i buxhetit 4-mujor llogaria 602** është në masën 20%, janë bërë likuidimet në lidhje me shërbimet bazë të institucionit siç janë
 - “*Shërbime nga të tretë*” të cilat janë në vlerën **9.948.562 lekë** ku përfshihen pagesat për shërbimet si Energji elektrike, Ujë, Shërbim postar, Shërbim i sigurimit dhe ruajtjes së objekteve, Internet dhe Shërbime të tjera ku vlerën më të madhe në këtë shërbim e zënë analizat e kryera në ISUV, Enti farërave, etj.
 - “*Shpenzime për qiramarrje*” në vlerën **3.407.630leke** janë pagesat e qirasë për zyrat e inspektorëve veterinerë në pikat doganore dhe për ambiente me qira për Drejtorinë e Përgjithshme.
 - “*Shpenzime transporti*” në vlerën **2.432.660lekë** janë pagesat për shpenzimet e sigurimit të mjeteve të transportit, taksa, kolaudim, etj., të cilat janë bërë gjatë tremujorit të parë 2022. Shpenzime të cilat janë bazë për funksionimin e mjeteve të institucioneve të AKU-së.
 - “*Materiale dhe Shërbime të Përgjithshme*” në vlerën **1.728.761 lekë**, janë pagesa Kancelari, Materiale pastrim dezinfektim, Toner, në disa Drejtori Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë bërë prokurimet për këto zëra.
 - “*Shpenzime të tjera operative*” në vlerën **1.461.715 lekë**, janë pagesa për detyrime gjyqësore, shpenzime për honorarë, etj.
 - “*Shpenzime udhëtimi*” në vlerën **668.124 lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për “*Shpenzime udhëtim e dieta brenda vendit*” ,shpenzimet që të gjithë institucionet e varësisë kryejnë për pagesën e dietave të punonjësve të tyre që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre. *Shpenzime udhëtim e dieta jashtë shtetit*” përfshihen udhëtimet e punonjësve për trajnime dhe pjesëmarrje në work-shope, konferenca jashtë vendit.

Në llogarinë 602 janë në proces prokurimi, procedura për blerje “Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik”, e cila zë një përqindje të konsiderueshme në buxhetin e kësaj llogarie, si dhe lidhja e kontratës me “Shtypshkronjën e letrave me vlerë” për shtypshkrime për sektorët e PIK në Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Theksojmë se, duke marrë në konsideratë pakësimin e buxhetit në llogarinë 602 në vlerën 11.780.000 lekë, do të ndikojë dhe në realizimin e disa objektivave siç janë marrja e mostrave dhe analizimi i tyre në institucione të tjera. Lutemi rishikimin e mundësisë që plani i marrjes së mostrave të realizohet dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të mos paguajë në institucionet të cilat janë në varësi të MBZHR, pasi mbetjet nga prokurimet do të përdoren për likuidimin e detyrimeve të krijuara rishtazi gjatë vitit 2022, siç janë vendimet gjyqësore.

3. **Realizimi i buxhetit 4-mujor në llogarinë 606 është realizuar ne masën 12% dhe vlerë 180.000 lekë.** Janë kryer pagesa për buxhetet familjare si shpërblim për dalje ne pension, shpërblim për kalim sëmundje të rëndë dhe shpërblim për humbjen e të afërmeve.
4. **Realizimi i buxhetit 4-mujor në llogarinë 231,** në këtë zë nuk kemi realizim pasi nuk janë lidhur Kontratat për tre projektet e kësaj llogarie :

- Projekti “Pajisje specifike për grupet e inspektimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” në vlerën 45.000.000 lekë, është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka depozituar kërkesën , specifikimet teknike si dhe fondin limit pranë kësaj Agjencie dhe është në pritje për lidhjen e kontratës.
- Projekti “Pajisje ftohëse dhe ngrirës (frigorifer) për Sektorët e laboratorëve dhe PIK të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” në vlerën 3.600.000 lekë, është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka depozituar kërkesën, specifikimet teknike si dhe fondin limit pranë kësaj Agjencie dhe është në pritje për lidhjen e kontratës.
- Projekti “Blerje pajisje laboratorike për laboratorin të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë” në vlerën 56.155.000 lekë është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka hartuar kërkesën dhe specifikimet teknike dhe është në proces të studimit të tregut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

